

LIGJ
Nr. 35/2013

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 9103, DATË 10.7.2003
“PËR MBROJTJEN E LIQENEVE NDËRKUFITARE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr. 9103, datë 10.7.2003 “Për mbrojtjen e liqeneve ndërkufitare”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Kudo në ligj emërtimi:

- a) “Inspektorati Shtetëror i Mjedisit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit”;
- b) “Inspektorati i Peshkimit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati që mbulon fushën e peshkimit”;
- c) “Policia e Ndërtimit” zëvendësohet me emërtimin “Inspektorati Ndërtimor e Urbanistik Përgjegjës”.

Neni 2

Neni 23 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 23

1. Për kundërvajtjet administrative të përcaktuara në nenin 22 të këtij ligji, inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit, jep dënim kryesor me gjobë si më poshtë:

- a) Për shkronjat “dh”, “e”, “ë” dhe “f” nga 100 000 deri në 300 000 lekë;
- b) Për shkronjat “b”, “c” dhe “d” nga 300 000 deri në 500 000 lekë;
- c) Për shkronjat “a” dhe “ç” nga 500 000 deri në 1 000 000 lekë.

2. Krahas dënimit me gjobë, inspektorati që mbulon fushën e mbrojtjes së mjedisit mund të vendosë edhe dënimin plotësues të mbylljes së përkohshme ose të përhershme të veprimtarisë, në varësi të ndotjes dhe dëmtimit të shkaktuar.

3. Shqyrtimi i vendimit bëhet në përputhje me ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”.

4. Sipas nevojave të rastit, në përputhje me këtë ligj dhe ligjin për inspektimin, inspektorati merr masa urgjente.”.

Neni 3

Neni 24 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 24
Ankimi

Kundër vendimit të inspektoratit mund të bëhet ankim në përputhje me ligjin për inspektimin.”.

Neni 4

Dispozitë kalimtare

Organi ekzistues inspektues vazhdon të ushtrojë funksionin e vet sipas organizimit aktual deri në krijimin e organit të ri, sikurse parashikohet në ndryshimet e bëra në këtë ligj.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Miraturar në datën 14.2.2013

Shpallur me dekretin nr. 7994, datë 1.3.2013 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bujar Nishani